

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Nr. Regj.Themeltar 3201/444/1431

Nr. Vendimi 1914

Data e regj.06.12.2021

Data 07.09.2022

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

GJYQTARE: REXHINA MERLIKA

Asistuar nga sekretar gjyqësor Shefqet Shehu, sot në Tirane më datë 07.09.2022, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale Nr.1431 akti në ngarkim:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga Prokuror Milan Laskaj.

I PANDEHUR: Dardan Jaku, i biri i Besmir dhe i Mejreme, i datëlindjes 08.03.1984, lindur në Nikoliq/ Kukës dhe banues në rrugën "Bebe Rexha", në Tiranë, beqar, me gjëndje gjyqësore i dënuar më parë, (recidivist i posaçën), me shtetësi shqiptare, mbrojtur nga Av.Bilbil Gjana, me numër license nr. 5214, i zgjedhur nga i pandehuri.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në prani të prokurorit, të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre, si dëgjoi palët të cilat në konkluzionet përfundimtare kërkuan:

Prokurori: Deklarimin fajtor të të pandehurit Dardan Jaku, për kryerjen e veprës penale të "Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike" të parashikuar nga neni 283/prg.1 i Kodit Penal dhe në mbështetje të këtij neni, dënimin e tij me 6 (gjashtë) vite burgim. Sygjerojmë gjykatën që në caktimin e dënimit të aplikohen përcaktimet e nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dhe në mbështetje të këtij neni, dënimin e tij me 4 (katër) vite burgim. Shpenzimet procedurale të kryera gjatë hetimeve paraprake, t'i ngarkohen të pandehurit.

Mbrojtja e të pandehurit: Kërkoj minimumin e dënimit dhe kërkoj që të aplikohet neni 59 i K.Penal pasi sasia është e vogël, e ka për përdorim vetjak dhe ka një fëmijë me sëmundjen e autizmit në përkujdesje.

-I pandehuri u shpreh i penduar dhe kërkoi mëshirë.

VËREN

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka sjellë për gjykim çështjen penale objekt gjykimi në ngarkim të të pandehurit Dardan Jaku akuzuar për kryerjen e veprës penale

"Prodhimi dhe shitja e narkotikeve", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, kryer në prani të rrethanës rënduese, "kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë" parashikuar nga neni 50/ç e Kodit Penal.

Nga aktet e seancës paraprake datë 04.04.2022 rezulton se i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar, pasi nuk u parashtrua asnjë pretendim pavlefshmërie, papërdorshmërie të provave, apo kërkim për marrjen e provave të reja, duke pranuar që gjykimi të zhvillohet në gjendjen që janë aktet në fashikullin e prokurorisë të sjellë për gjykim.

Në këto kushte gjykata bazuar në nenet 403, 332/dh gërma "c" (i ndryshuar me Ligjin Nr. 41/2021) dhe nenin 405/6 të K.Pr. Penale, pasi u njoh me aktet hetimore, vendosi të procedojë me gjykim të shkurtuar, duke çmuar për zgjidhjen e çështjes penale në gjendjen që janë paraqitur aktet nga organi i akuzës, pasi jo vetëm nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij nuk u paraqitën pretendime pavlefshmërie, papërdorshmërie apo marrje të provave të reja, por as nga gjykata nuk u konstatuan pavlefshmëri apo papërdorshmëri të provave.

Ky disponim i gjykatës është në përputhje me dispozitat proceduriale të cilat parashikojnë gjykimet e posaçme si dhe të *Vendimit Unifikues Nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara*, sipas të cilit ky lloj gjykimi i posaçëm eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Ky gjykim i posaçëm bën që gjykimi të zhvillohet në tërësi sipas fashikullit të prokurorit, i cili kthehet në dosje gjyqësore dhe që përbën bazën e shqyrtimit të çështjes, çmuarjes dhe analizës së provave në gjendjen që kanë ardhur për gjykim.

Nga shqyrtimi i akteve në seancë gjyqësore rezulton se:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialit kallëzues dërguar nga DPV Tiranë, më datë 23.09.2021 ka regjistruar procedimin penal Nr. 6656 për veprën penale "Prodhim dhe shitje e narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, në ngarkim të personit nën hetim Dardan Jaku.

Nga ana e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, janë siguruar informacione në rrugë operative se shtetasi Dardan Jaku, merret me shitje lëndësh narkotike të llojit heroinë, në zona të ndryshme në qytetin e Tiranës.

Në bazë të këtyre të dhënave është organizuar puna për kapjen e tij. Në datë 22.09.2021, rreth orës 11.00 në rrugën "George Bush", nga shërbimet e policisë është konstatuar shtetasi Dardan Jaku pranë fast food "Patato". Në këto kushte, ky shtetas është ndaluar dhe ndaj tij është ushtruar kontroll fizik, gjatë të cilit i janë gjetur në xhepin e pantallonave një kuti shkepëse, brenda së cilës kishte tre qese plastike në formë dozash të mbyllura në majë me djegie, ku brenda tyre kishte material pluhur me ngjyrë të kuqërremtë, të dyshuar si lëndë narkotike e llojit "Heroinë". Më pas është ushtruar kontroll në banesën e shtetasit Dardan Jaku, ku në dhomën e gjumit në dollapin e rrobave është konstatuar një qese plastike me ngjyrë të zezë, brenda së cilës kishte material pluhur me ngjyrë të kuqërremtë, të dyshuar si lëndë narkotike e llojit "Heroinë".

Është ushtruar kontroll edhe në fast food "Patato" por gjatë kontrollit nuk janë gjetur sende të kundërligjshme apo që kanë lidhje me veprën penale.

Lënda e dyshuar si narkotike është sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe pas peshimit rezultoi me peshë të përgjithshme me gjithë amballazh 1.8 (një pikë tetë) gram, e cila më pas u fut në gesen e provave me numër unik B20002721.

I pyetur me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime shtetasi Dardan Jaku, ka deklaruar se është përdorues i lëndëve narkotike prej dy vjetësh dhe sasinë e gjetur nga policia e ka për përdorim vetjak.

Nga akti ekspertimit kimik nr.11406, datë 09.11.2021 rezulton se: "analiza me GC/MS për materialet objekt ekspertimi treguan për praninë e heroinës. Pesha e materialeve pa ambalazh është 1.359 gr". Nga akti ekspertimit toksikologjiko ligjor, Nr.2453, datë 04.10.2021, i shtetasit Dardan Jaku ka rezultuar se ky shtetas është përdorues i lëndës narkotike heroinë

Sa më sipër, nga prokurori është konkluduar se rezulton e provuar se shtetasi Dardan Jaku me veprimet e tij ka konsumuar të gjithë elementët e veprës penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, kryer në prani të rrethanës rënduese të parashikuar nga neni 50/ç i K.Penal, në formën e mbajtjes së kësaj lënde, jo vetëm për përdorim vetjak, duke u marrë si i pandehur.

Lidhur me akuzën në fashikullin e gjykit janë administruar provat si më poshtë: Procesverbal i kapjes në flagrancë datë 22.09.2021; Procesverbal i arrestimit në flagrancë datë 22.09.2021; Procesverbal i kontrollit personal datë 22.09.2021; Procesverbalet për sekuestrimin e sendeve datë 22.09.2021 së bashku me vendimin e vleftësimit të prokurorit; Procesverbal i kontrollit të banesës datë 22.09.2021, së bashku me vendimin e vleftësimit të prokurorit; Procesverbal për peshimin e provës materiale datë 22.09.2021, së bashku me tabelën fotografike; Akt ekspertimi kimik nr. 11406, datë 09.11.2021 i IPSH-së; Akt ekspertimi mjekoligjor Nr.2453, datë 04.10.2021 i IML Tiranë i shtetasit Dardan Jaku.

Për sa më sipër prokurori kërkoi: Deklarimin fajtor të të pandehurit Dardan Jaku, për kryerjen e vepres penale të "Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike" të parashikuar nga neni 283/prg.1 i Kodit Penal dhe në mbështetje të këtij neni, dënimin e tij me 6 (gjashtë) vite burgim. Sygjerojmë gjykatën që në caktimin e dënimit të aplikohen përcaktimet e neni 406 të Kodit të Procedurës Penale dhe në mbështetje të këtij neni, dënimin e tij me 4 (katër) vite burgim. Shpenzimet procedurale të kryera gjatë hetimeve paraprake, t'i ngarkohen të pandehurit.

Mbrojtësi i të pandehurit: Kërkoj minimumin e dënimit dhe kërkoj që të aplikohet neni 59 i K.Penal, pasi sasia është e vogël, e ka për përdorim vetjak dhe ka një fëmijë autik për t'u kujdesur.

Vlerësimi i Gjykatës.

Në rastin konkret ndodhur përpara faktit të parashtruar me sipër, pretendimeve dhe provave në gjykim, gjykata çmon se veprimet e të pandehurit Dardan Jaku, plotësojnë elementët e figurës së veprës penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", kryer në rrethana rënduese, parashikuar nga neni 283/1 dhe 50/ç i Kodit Penal.

Sipas dispozitës së mësipërme është parashikuar se: "Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet...".

Në lidhje me objektin e kësaj vepre penale, çmohet se janë cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura me Ligjin Nr.7975, date 26.07.1995 "Për barnat narkotike dhe psikotrope", të cilat garantojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitave ligjore përkatëse të lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime të kundërligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e personit, funksionimin normal të veprimtarisë së organeve jetësore të tij. Në rastin konkret, ky objekt është cënuar nga i

pandehuri, i cili me veprimet e tij të drejtpërdrejta dhe të vullnetshme, ka konsumuar elementët e kësaj figure krimi, në formën e mbajtjes së sasisë prej 1.359 graë, e ndarë në 4 (katër) doza, lëndë narkotike e llojit heroinë.

Lidhur me anën objektive të veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, gjykata çmon se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Në rastin e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, është përcaktuar se ajo kryhet në disa forma shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, transportimi, dërgimi, dorëzimi dhe mbajtja, **në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre**. Kjo do të thotë se veprimet e mësipërme aktive të subjektit aktiv të veprës penale duhet të jetë në kundërshtim me parashikimet e ligjit që rregullon regjimin juridik të lëndëve narkotike.

Gjykata nga tërësia e provave dhe faktit të ndodhur krijon bindjen se i pandehuri Dardan Jaku ka konsumuar elementët e kësaj vepre penale nëpërmjet veprimeve aktive të kryera prej tij, të shfaqura në formën e mbajtjes së lëndës narkotike konkretisht me datë 22.09.2021 ora 11.00, në rrugën “George Bush”, pranë një fast-food është ndaluar shtetasi Dardan Jaku, dhe gjatë kontrollit të tij në xhepin e pantallonave është gjetur një kuti shkrepe brenda së cilës kishte tre qese plastike në formë dozash të mbyllura në majë me djegie, ku brenda tyre kishte material pluhur me ngjyrë të kuqërremtë, të dyshuar si lëndë narkotike e llojit "Heroinë". Është ushtruar kontroll në banesën e shtetasit Dardan Jaku, ku në dhomën e gjumit në dollapin e rrobave është konstatuar një qese plastike me ngjyrë të zezë, brenda së cilës kishte material pluhur me ngjyrë të kuqërremtë, të dyshuar si lëndë narkotike e llojit "Heroinë". Lënda e dyshuar si narkotike është sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe pas peshimit rezultoi me peshë të përgjithshme me gjithë ambalazh 1.8 (një pikë tetë) gram. Sipas aktit të ekspertimit kimik të lëndës nr.11406, datë 09.11.2021 rezultoi se: "analiza me GC/MS për materialet objekt ekspertimi treguan për praninë e heroinës. *Pesha e pluhurave pa amabalazh është 1.359 gram*. Ndërsa nga akti ekspertimi toksikologjiko-ligjor nr.2453, datë 30.09.2021, ka rezultuar se: *Në urinën e shtetasit Dardan Jaku të vendosur në kontenier me qese prove me Nr. Unik X20000437, u zbulua prania e produkteve të metabolizimit të heroinës (monoacetylmorfinë) në organizimin e njeriut, pas përdorimit*.

Në rastin konkret rezultoi se i pandehuri Dardan Jaku mbante në kundërshtim me ligjin 4 (katër) doza lëndë narkotike të llojit heroinë, ku pas peshimit ato kanë rezultuar me peshë totale 1.359 (një pikë treqind e pesëdhjet e nëntë) gram. Pretendimi i mbrojtjes dhe të pandehurit se këto doza mbaheshin nga ky i fundit për përdorim vetjak nuk është i bazuar në ligj. Është e vërtetë që legjislatori ka përjashtuar nga përgjegjësia penale personat që mbajnë lëndë narkotike apo psikotrope në dozë të vogël dhe për përdorim vetjak, por në rastin konkret ky parashikim nuk gjen zbatim, pasi 4 (katër) dozat e sekuestruara të pandehurit me peshë prej 1.359 (një pikë treqind e pesëdhjet e nëntë) gram lëndë narkotike e llojit heroinë, nuk mund të konsiderohen si dozë e vogël dhe për përdorim vetjak.

Duke analizuar këtë element të veprës penale gjykata referohet jo vetëm në dispozitën konkrete penale, në rastin objekt shqyrtimi duke analizuar veprimet përkatëse të të pandehurit, por edhe unifikimin e praktikës gjyqësore të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Ligjvënësi, si kriter përcaktues për ekzistencën e vetë figurës së krimit dhe, për pasojë, të bazës së përgjegjësisë penale për personat që e konsumojnë atë, ka parashikuar dy rrethana specifike: *së pari*, mbajtjen e substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe të farave të bimëve narkotike jo për përdorim vetjak dhe *së dyti*, edhe kur rezultoi i provuar fakti që, këto lëndë

mbahen nga personi për përdorim vetiak, në aspektin sasior, ato nuk duhet të jenë në doza të vogla. Përsa i përket rrethanës së parë, Gjykata vë në dukje se ajo është rrethanë fakti - rezultat i procesit të të provuarit nëpërmjet analizës, në zbatim të kërkesave të dispozitës së nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, të provave dhe indicieve, në të cilat duhet të bazohet gjykata për të arritur në përfundime të drejta, nëse lëndë narkotike dhe psikotrope, etj. mbahet nga personi për përdorim vetjak apo për të kryer në vijim, ndonjërin apo disa nga veprimet e tjera të përmendura në dispozitë, që janë elementë të anës objektive të figurës së krimit të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve. Theksojmë se, e veçanta e rrethanës “përdorimi vetjak” është se ajo nuk qëndron më vete. Ajo nuk mund të shërbejë e vetme për të arritur në përfundimin se, duke u bazuar vetëm në ekzistencën e saj nuk ekziston edhe figura e krimit të parashikuar në nenin 283 të Kodit Penal. Kështu, ajo nuk mund të shërbejë e vetme për të arritur në përfundimin se nuk ekziston baza ligjore (figura e krimit) për të marrë mbajtësin e tyre në përgjegjësi penale.

Përkundrazi, për të mos u marrë mbajtësi i lëndëve të tilla në përgjegjësi penale duhet të provohet se ekziston edhe rrethana e dytë, që ka lidhje me sasinë e këtyre lëndëve, e cila, sikurse shprehet ligjvënësi në vetë dispozitën e përmendur, duhet të jetë “në doza të vogla”. Nocioni juridiko-penal që është shprehur nga ligjvënësi me togfjalëshin “në doza të vogla”, edhe pse nuk mund të bëhet ndonjë përcaktim numerik i sasisë së lëndëve të ndaluara që do të shprehte në peshë sasinë e dozës për t’u konsideruar e vogël, duhet të interpretohet në kuptimin që, në aspektin sasior, lëndë narkotike dhe psikotrope, etj., duhet të jetë në atë masë sa të konsiderohet realisht e vogël për përdorim vetjak nga ana e individit konkret dhe jo në përgjithësi. Ajo nuk duhet të tejkalojë aftësitë fiziko-biologjike të individit përdorues dhe brenda kufijve të tolerancës që paraqet organizmi i tij për llojin konkret të lëndës narkotike, në momentin dhe kushtet e përdorimit të kësaj lënde, për të mos krijuar tek ai efekte tej asaj shkalle që do t’i dëmtonin shëndetin. Kështu, doza e vogël, në kuptimin ligjor të saj, konsiderohet jo ndarja fizike në disa të tilla, por sasia e lëndës apo substancës narkotike e psikotrope që ajo përmban si e tërë dhe që sipas ekspertëve vlerësohet si dozë e vogël.

Gjykata çmon se, përcaktim i tillë i nocionit “në doza të vogla”, për efekte të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të Kodit Penal, veç rolit parandalues që luan për ruajtjen e shëndetit të përdoruesve dhe personave që kanë vartësi nga droga, luan dhe rolin e parandalimit të përgjithshëm në drejtim të luftës kundër fenomenit të përdorimit të kundraligjshëm të këtyre lëndëve, i cili ku gjen përhapje në përmasa të mëdha, shndërrohet në patologji sociale. Në kushtet kur tek ne ende nuk janë përcaktuar, me ligj të posaçëm apo me akte nënligjore, rastet e përdorimit të lëndëve narkotike dhe psikotrope “në përputhje me ligjin dhe jo në kapërcim të tyre”, përcaktimi si më sipër i nocionit juridiko-penal “në doza të vogla” shërben edhe për ngushtimin, në një masë të arsyeshme, të hapësirave, shfrytëzimi i të cilave, në forma të padrejta, nga keqbërësit, do të ndikonte në shmangien pa të drejtë nga përgjegjësia penale të përdoruesve të lëndëve narkotike dhe psikotrope, të cilët shpesh konstatohet se janë edhe shpërndarës të këtyre lëndëve. Për shkak të njohurive të posaçme që kërkohen në fushën e toksikologjisë, gjykata për zgjidhjen e çështjes që lidhet me sasinë e lëndës narkotike të nevojshme për përdorim vetjak duhet të thërrasë në çdo rast specialistë të fushës, si toksikologë apo mjekë terapistë, mendimi shkencor i të cilëve do të shërbejë si njëri prej kriterëve ku ajo do të mbështetë arsyetimin e vendimit të saj. Por, për zgjidhjen përfundimisht të çështjes, gjykata duhet të mbështetet edhe në kriterin tjetër, me të cilin lidhet ngushtësisht ai i pari, kriter ky, që konkretizohet nëpërmjet sqarimit të rrethanave faktike të mbajtjes së sasisë konkrete të lëndës

narkotike apo psikotrope nga personi konkret, nëpërmjet zbatimit të kërkesave ligjore të Kodit të Procedurës Penale që vlejnë për realizimin me sukses të procesit të të provuarit, në përgjithësi.

Gjithashtu, në përcaktimin e dozës së vogël për përdorim personal, Gjykata mban parasysh vendimin njësues Nr. 138, datë 16.11.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në këtë vendim, thuhet se, në aspektin ligjor, formulimi i nenit 283 të Kodit Penal parashikon një dënim penal të vetëm, pa bërë dallim, mbi llojet e drogave në droga të lehta dhe në droga të rënda, si dhe të sasisë së mbajtur. Ky Kolegj vlerëson se, në bazë të dispozitës ligjore të parashikuar në nenin 283 të Kodit Penal, duhet bërë një dallim për sa i përket kriminalizimit të atyre sjelljeve penalisht të dënueshme që kanë të bëjnë: i) me mbajtjen e lëndës narkotike për qëllim shitjeje, ofrimi, dhënieje a marrjeje, shpërndarjeje, transportimi, dërgimi, dorëzimi, etj. ii) në raport me atë të mbajtjes për përdorim personal. Në vlerësimin e ligjvënësit tregtimi, transportimi, shitja apo shpërndarja e lëndëve narkotike nuk janë të vetmet veprime që përbëjnë një rrezik potencial, pasi edhe blerja, edhe mbajtja e këtyre lëndëve paraqesin gjithashtu rrezik, për shkak se krijojnë mundësinë që ato të shpërndahen te palët e treta, pra të kalojnë nga një individ tek tjetri pa asnjë kontroll. Kolegji vlerëson se shpërndarja e drogës tek të tjerët, në të gjitha format si shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, pra shpërndarja në çdo formë qoftë falas përmes dorëzimit apo dhënies, apo kundrejt pagesës përbën një veprë penale të dënueshme nga neni 283 i Kodit Penal. Pra, mbajtja për qëllim shitjeje, ofrimi, dhënieje a marrjeje, shpërndarjeje, transportimi, dërgimi, dorëzimi, përbën një veprim penalisht të dënueshëm.

Ndërsa rasti për përdorim personal, në doza të vogla, nuk përbën veprë penale. Kjo për arsye se nëse blerja dhe mbajtja e substancave narkotike kufizohet në sasi të vogla, për përdorim vetjak të rastit, rreziku konkret që këto lëndë të kalojnë te një person i tretë nuk është domethënës, për pasojë interesi publik për të vendosur dënime penale në këto raste nuk është i justifikuar. Gjykata vlerëson se përmbajtja e nenit 283 të Kodit Penal, i cili përjashton nga ndjekja penale individët që mbajnë lëndë narkotike për përdorim vetjak dhe në doza të vogla, ka respektuar kërkesën kushtetuese të proporcionalitetit, të sanksionuar në nenin 17 të Kushtetutës. Vetëm në këto raste shkelja e kryer konsiderohet e tillë që nuk ka asnjë interes publik për ndjekjen penale të tyre dhe në miratimin e këtij parashikimi ligjvënës ka respektuar balancën midis fajësisë të autorit, rrezikshmërisë së veprës penale dhe masës ndëshkuese të saj.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është ndalur në analizën e dallimit të qëllimit për përdorim vetjak. Për të bërë dallimin e mbajtjes për qëllim përdorimi vetjak, nga ana e ligjvënësit është vendosur si kriter ligjor mbajtja në doza të vogla. Në interpretim të këtij kriteri ligjor, Kolegji vlerëson se Vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 27.03.2008, duhet të shihet në funksion të dallimit të qëllimit për përdorimin vetjak apo për qëllim tjetër, prandaj në çdo rast kërkohet një vlerësim, në radhë të parë, i kriterit sasior, i cili duhet t'i referohet një akti ekspertimi toksikologjik mbi kapacitetin absorbues fizik të subjektit përdorues të lëndës narkotike apo psikotrope në atë rast konkret. Në bazë të një interpretimi literal të dispozitës, Kolegji vëren se, në parim, për të gjitha llojet e lëndëve narkotike apo psikotrope, pavarësisht ndarjes apo kategorizimit të tyre, parashikohet mundësia e përdorimit të tyre në doza të vogla. Çka do të thotë se për të gjithat llojet e lëndëve narkotike të ndaluara, duhet të ekzistojnë sasi të vogla të lëndës narkotike, të cilat edhe pse jo të njëjta për çdo lloj lëndë narkotike, përbëjnë raste të përdorimit vetjak duke përjashtuar përgjegjësinë penale për kryerjen e veprës penale të rasteve në fjalë.

Në ligjin penal, nuk është e përcaktuar sasia e lëndës narkotike apo psikotrope që duhet konsideruar si dozë e vogël. Në mungesë të këtij përcaktimi, Kolegji Penal vlerëson se kriteret për përcaktimin e dozës së vogël që duhet të ndjekin gjykatat e themelit janë: 1) sasia e lëndës narkotike apo psikotrope, 2) mënyra dhe rrethanat e mbajtjes së saj, 3) çdo indicie tjetër, siç mund të jetë mënyra e ruajtjes dhe e mbajtjes, gjetja e mjeteve për mbajtjen, ndarjen, përzierjen, ndarjen, paketimin, peshores me ndjeshmëri të lartë: si qese farmaceutike, thika, letër alumini, gjetja e parave të fituara nga cedimi i lëndës narkotike, kapja e subjektit aktiv në vende të njohura për shpërndarjen e lëndëve narkotike, gjetja e një lloji të vetëm apo më shumë së një lloji të lëndës narkotike, gjetja e lëndëve që shërbejnë si prekursorë për përgatitjen dhe ndarjen e saj, etj. Përcaktimi i sasisë së mbajtur për përdorim vetjak, në mungesë të një përcaktimi sipas një akti ligjor apo nën ligjor, nga ana e ekspertit toksikologjik, duhet të kryhet mbi bazën e një vlerësimi që rrjedh në bazë të një studimi të përgjithshëm të fenomenit të varësisë nga lënda narkotike të një subjekti përdorues, ku të përcaktohen kufijtë maksimalë të dozës për përdorim ekskluzivisht personal për çdo substancë narkotike apo psikotrope. Në çdo rast, eksperti duhet të përcaktojë për çdo lloj të lëndës narkotike: a) dozën mesatare të vetme, e kuptuar si sasia e substancës aktive për çdo marrje të vetme, e aftë për të prodhuar tek një subjekt përdorues dhe dipendent efektin psikotrop apo narkotik; b) frekuencën mesatare të përditshme të marrjes; c) sasinë e substancës aktive të marrjes në mënyrë të përditshme; d) fuqinë për të shkaktuar ndryshime të sjelljes dhe rënies së aftësive psikomotore, dh) moshës dhe aftësive fizike të përdoruesit vetjak konkret.

Sa më sipër, rezulton se veprimet e kundërligjshme të të pandehurit konsistojnë në mbajtjen e lëndës narkotike e llojit heroinë në sasinë 1.359 grame, e cila nuk konsiderohet në doza të vogla, gjatë kohës që ai ishte në marrëdhënie pune, mënyra e gjetjes së saj, në një kuti shkrepëse në xhepin e tij, dhe vendi tjetër ku mbahej lënda në shtëpinë e tij, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se janë konsumuar elementët e kësaj vepre penale. Fakti penal në ngarkim të të pandehurit rezulton i provuar si procesverbal i kapjes në flagrancë datë 22.09.2021, procesverbal i kontrollit personal datë 22.09.2021, procesverbalet për sekuestrimin e sendeve date 22.09.2021; procesverbal i kontrollit të banesës datë 22.09.2021, procesverbal për peshimin e provës materiale datë 22.09.2021 së bashku me tabelen fotografike, akt ekspertimi kimik nr. 11406, datë 09.11.2021 i IPSH-së, akt ekspertimi mjekoligjor Nr.2453, datë 04.10.2021 i IML Tiranë i shtetasit Dardan Jaku.

Subjekti. Personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kriteret ekskluzive ligjore (condicio sine qua non): i) Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe ii) të jetë i përgjegjshëm për veprën penale në momentin e kryerjes së saj. Në rastin konkret, i pandehuri Dardan Jaku në kohën e kryerjes së veprës ka qënë madhor (ai është i datëlindjes 1984), po ashtu sikurse u theksua në paragrafin e mësipërm, ai është i përgjegjshëm para ligjit, si rrjedhojë ai ka qënë i aftë të posedojë aftësi intelektuale dhe vultive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tij dhe t'a kontrollojë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se i pandehuri Dardan Jaku është subjekt i përgjegjshëm penalisht.

Ana subjektive. Gjykata vlerëson se ky element i figurës së veprës penale lidhet me qëndrimin psikik që mban personi kundrejt veprës së kryer prej tij. Faji, pa të cilin nuk mund të ketë përgjegjësi penale "*nullum crimen, nulla poena sine culpa*", është element i përgjegjësisë penale që parashikohet shprehimisht në nenin 14 të Kodit Penal. Ai përmban në vetvete dy momente: atë intelektual dhe atë që lidhet me vullnetin. Momenti intelektual tregon nëse subjekti

nga pikëpamja e ndërgjegjes ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm të veprës, të parashikonte ose jo ardhjen e pasojave të dëmshme, kurse momenti që është i lidhur me vullnetin tregon nëse ai dëshiron ose jo për të kryer një veprim të kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm dhe nëse dëshironte ardhjen e pasojës. Nëpërmjet individualizimit të këtyre dy momenteve, intelektual dhe volutiv, është e mundur të bëhet dallimi i dy formave të fajësisë, të dashjes e të pakujdesisë.

Për të qenë para veprës penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, duhet që i pandehuri të veprojë me dashje. Shkaqet apo motivet që e kanë shtyrë të pandehurin të kryejë këtë veprë penale nuk kanë rëndësi për cilësimin ligjor të veprimeve të të pandehurit, por mbahen parasysh nga Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit.

Në rastin konkret, i pandehuri ka vepruar me dashje duke mbajtur në mënyrë të kundërligjshme 3 qese plastike në doza të vogla, dhe 1 qese plastike me lëndë narkotike të llojit heroinë, me peshë totale 1.359 gram.

Vepra penale është kryer nga i pandehuri me dashje në formën e dashjes direkte, pasi ai ka mbajtur lëndën narkotike, duke ditur kundërligjshmërinë e veprimeve të tyre dhe pasojat e veprës.

Sa më sipër u arsyetua, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "Prodhimi dhe Shitja e Narkotikëve" parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Fajësia e tij në kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet rezultoi e provuar plotësisht nga të gjitha provat e sipërcituara të administruara nga gjykata në seancë gjyqësore.

Lidhur me caktimin e llojit dhe masës së dënimit.

Dënimi penal në të drejtën penale kupton atë masë shtrënguese, që zbatohet nga shteti nëpërmjet Gjykatave, në bazë të ligjit, kundër personave fajtorë që kanë kryer veprë penale. Kriteret dhe parimet themelore që duhet të zbatojë gjykata në caktimin e një dënimi të caktuar, janë të përcaktuara në mënyrë të përgjithshme, pikërisht në nenin 47 të Kodit Penal. Konkretisht, në këtë dispozitë, sanksionohet se: "Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese".

Në mbështetje të parimeve të pasqyruara më lartë, konkludohet se gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, i referohet në rradhë të parë llojit të dënimit dhe kufijve të vendosur në dispozitën ligjore konkrete në bazë të së cilës është bërë cilësimi i veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri.

Gjykata, në përcaktimin e llojit dhe masës konkrete të dënimit, në kuadër të respektimit të parimit të individualizimit të dënimit, duhet të vlerësojë këto elementë:

Llojin dhe kufijtë e dënimit të parashikuar në dispozitën konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal (në rastin konkret, parashikohet dënim me burgim nga 5 deri në 10 vjet);

- Rrezikshmërinë e veprës penale (në rastin konkret, vepra penale në ngarkim të të pandehurit paraqet rrezikshmëri të theksuar shoqërore);
- Rrezikshmërinë e autorit të veprës penale (autori paraqet rrezikshmëri të theksuar shoqërore pasi ai ka qenë i dënuar edhe më parë për të njëjtën veprë penale);
- Shkallën e fajit (vepra penale është kryer me dashje që është shkalla më e rëndë e fajësisë);

- Rrethanat lehtësuese dhe rënduese (rënduese është fakti që i pandehuri ka qenë i dënuar më parë, pra është recidivist i posaçëm).

Gjykata mban parasysh edhe rrethanat që justifikojnë lehtësimin e dënimit:

- faktin që i pandehuri Dardan Jaku është përdorues i lëndës narkotike të llojit heroinë; pranimin se ai e ka kryer veprën penale;
- faktin se i pandehuri si gjatë hetimit ashtu edhe gjatë gjykimit ka shprehur pendim të thellë.

Lidhur me masën e dënimit me burgim që duhet të caktohet ndaj të pandehurit, gjykata çmon se masa e kërkuar nga prokurori është në përputhje me tërësinë e rrethanave të ngjarjes, mekanizimit të saj, rrethanave lehtësuese, rënduese, të cilat në tërësinë e tyre përlligjin dënimin në minimumin e përcaktuar në ligj. I pandehuri rezulton se jo vetëm ka qenë i dënuar më parë sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, Nr.7, datë 30.09.2021, por me vendimin Nr.2651, datë 09.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ai është deklaruar fajtor dhe dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 të Kodit Penal, me 3(tre)vjet e 4(katër) muaj burgim, duke aplikuar neni 59 K.Penal, pezullimin e vendimit me burgim për një kohë prove 3(tre) vjet me kusht që të moskryejë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Por, ky urdhërim është shkëlur prej tij, duke kryer të njëjtën vepër penale gjë që përbaën rrethanë rënduese të parashikuar nga neni 50 gërma “ç” e Kodit Penal “*Kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë*”.

Gjykata çmon se pandehuri për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal duhet dënuar me 6 (gjashtë) vite burgim; Në kushtet e aplikimit të gjykimit të shkurtuar në masën e dënimit të dhënë i zbritet 1/3 e dënimit të dhënë, duke e dënuar përfundimisht me 4(katër) vite burgim.

Aplikimi i këtij dënimi për të pandehurin është në përputhje të plotë me rëndësinë e faktit, rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe realizon plotësisht qëllimin kompleks të dënimit penal për ndëshkimin, riedukimin e tyre dhe parandalimin e përhapjes së këtyre veprave penale në shoqërinë tonë.

Në zbatim të nenit 14 të Ligjit 8328, datë 16.04.1998“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” i ndryshuar, vuajtja e dënimit të kryhet nga i pandehuri në një burg të sigurisë së zakonshme.

Në përfundim të gjykimit në zbatim të nenit 190/1/b të K. Pr. Penale, provat materiale sekuestruar sipas proces-verbalit, date 22.09.2021, (lenda narkotike e llojit heroine ne masen 1.359 gram) të asgjësohet dhe telefoni i markes Iphone 7+ me nr imei 356568081229805, t'i kthehet të pandehurit Dardan Jaku.

Duke qenë se, i pandehuri u deklarua fajtor dhe u dënua për veprën penale për të cilën akuzohet, bazuar në nenin 485 të K.Pr.Penale, shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit Dardan Jaku.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 283/1, 47, 48/ç, 49, 50/ç të K. Penal dhe në nenet 190/1, 379, 383, 384, 406/1 të K.Pr. Penale,

V E N D O S I

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Dardan Besmir Jaku për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij sipas kësaj dispozite me 6(gjashtë) vite burgim.

2. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit Dardan Besmir Jaku i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 4 (katër) vite burgim.

3. Në zbatim të nenit 190/1 gërmat “b” të K.Pr.Penale, prova materiale e sekuestruar sipas proces-verbalit date 22.09.2021, (lënda narkotike e llojit heroinë në masën 1.359 gram) të asgjësohet.

4. Në bazë të nenit 190/1/ç të K.Pr.Penale, prova materiale sekuestruar me proceverbalin datë 22.09.2021, telefon i markës Iphone 7+ me nr imei 356568081229805, i kthehet të pandehurit Dardan Jaku.

5. Vuajtja e dënimit me burgim për të pandehurin, fillon nga dita e arrestit në flagrancë, datë 22.09.2021, dhe në bazë nenit 18 të Ligjit nr. 81/2020, të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

6. Shpenzimet proceduriale në fazën e hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.

7. Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga palët brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall ne Tiranë sot me datë 07.09.2022

SEKRETAR

GJYQTARE

SHEFQET SHEHU

REXHINA MERLIKA

SHPENZIMET GJYQËSORE

Për njoftime 150 Lekë